

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. nr. 51/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, në Trupin Gjykses të përbërë nga Gjyqtarja e EEULEX-it Franciska Fiser, si Kryetare e Trupit Gjykses, dhe Gjyqtarët e EULEX-it Vladimir Mikula dhe Arkadiusz Sedek si anëtarë të Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e zyrtares Ligjore të EULEX-it Chiara Tagliani si Procesmbajtëse, në lëndën penale ndaj:

M. Z._____;

dhe

Rr. R._____;

të dytë të akuzuar me Aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të datës 23 prill 2014 numër PPS 90/13 për kryerjen e veprave penale:

“*Shkelja e fshehtësisë së procedurës*” në kundërshtim të nenit 400, Para. (2) lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK);

dhe M. Z._____, me të dhëna si më lart,

gjithashtu akuzohet në të njëjtën Aktakuzë për kryerjen e veprës penale ‘*Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare në tentativë*’, në kundërshtim të nenit 28 dhe 394, Para. (1) Nën-para. (1.7) KPK;

pas mbajtjes së seancave të Shqyrtimit Gjyqësor, të gjitha të hapura për publikun, më 13, 14 dhe 15 tetor 2015, dhe më 08, 09 dhe 10 dhjetor 2015, dhe më 02, 03 dhe 10 shkurt 2016, pjesërisht e mbyllur për publikun më 02 shkurt 2016, në prani të Prokurorit Special të Republikës së Kosovës, të Akuzuarit M.Z. _____ dhe Avokatit të tij Mbrojtës Gafur Elshani, të Akuzuarit Rr. R. _____ dhe Avokatëve të tij Mbrojtës Gregor Guy-Smith, Coleen Rohan dhe Tome Gashi;

pas tërheqjes së akuzës ndaj të Akuzuarit Rr. R. _____ me njoftimin e Prokurorit Special të datës 10 shkurt 2016;

pas këshillimit dhe votimit të Trupit Gjyqësor të mbajtur më 11 shkurt 2016;

sipas nenit 363, nën-para. (1.1) dhe nenit 366, para. (1) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPK) më 12 shkurt 2016, në një seancë publike në prani të të Akuzuarit M. Z. _____, Avokatit të tij Mbrojtës dhe Prokurorit të Shtetit;

nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

I.

Nën PIKËN 1, Shkelja e fshehtësisë së procedurës

Akuza ndaj të Pandehurit **RR. R.** _____ **REFUZOHET.**

II.

Nën PIKËN 1, Shkelja e fshehtësisë së procedurës

I Pandehuri **M. Z.**_____ SHPALLET I PAFAJSHËM, sepse:

Nuk është vërtetuar se nga data 14 korrik 2013 deri 31 tetor 2013, në Kosovë, duke vepruar në bashkëkryerje me Rr. R._____, pas marrjes së informative konfidenciale lidhur me Dëshmitarin A nga Rr. R._____, i Pandehuri M. Z._____ duke aranzhuar takimin dhe duke u takuar me Dëshmitarin A më 29 dhe 30 tetor 2013 në restorantin D. në S._____ për të shfaqur, në prani të të tjerëve, se Dëshmitari A është dëshmitar për Prokurorinë në lëndën GJPP 27/12 (PPS 88/11), dhe duke kontaktuar anëtarët e ekipit të mbrojtjes së S. L._____ në lëndën GJPP 27/12 (PPS 88/11) gjatë dhe menjëherë pas takimit të datës 29 tetor 2013, pa autorizim ka zbuluar informata përkitazi me identitetin e Dëshmitarit A (i njohur si “Dëshmitari I” në lëndën GJPP 27/12 (PPS 88/11)), person nën masat mbrojtëse në procedurën penale GJPP 27/12 (PPS 88/11).

Prandaj, sipas nenit 364, para. (1) nënpara. (1.3) KPP, i Pandehuri **M. Z.**_____ **LIROHET NGA AKUZA**, për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e fshehtësisë së procedurës*” në kundërshtim të nenit 400, para. (2) lidhur me nenin 31 KPK.

III.

Nën PIKËN 2, Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare në tentativë

I Pandehuri **M. Z.**_____ SHPALLET I PAFAJSHËM sepse:

Nuk është vërtetuar se, nga data 28 tetor 2013 deri më 5 nëntor 2013, në Kosovë, duke:

- a) aranzhuar takimin me Dëshmitarin A në prani të M. M. _____ në restorantin D. _____ në S. _____ më 29 tetor 2013 dhe, në takim, së pari duke këmbëngulur që Dëshmitari A ta bëjë një video intervistë me të dhe pastaj duke këmbëngulur që Dëshmitari A është dëshmitar në lëndën GJPP 27/12 (PPS 88/11);
- b) takuar Dëshmitarin A në restorantin D. _____ në S. _____ më 30 tetor 2013, duke e sjellë në takim një kameraman, duke ia treguar Dëshmitarit A, në prani të M. M. _____, një kopje të nënshkruar të deklaratës së Dëshmitarit A dhënë EULEX-it, dhe duke u përpjekur ta bind Dëshmitarin A t'i falë njerëzit e emëruar në deklaratën e Dëshmitarit A; dhe
- c) duke e telefonuar Dëshmitarin A më 31 tetor 2013 për ta bindur Dëshmitarin A t'i falë njerëzit të cilët Dëshmitari A i kishte akuzuar në deklaratën e tij në këmbim të një falje publike nga ata dhe që Dëshmitari A t'i jepë fund historisë;
- i Pandehuri M. Z. _____ ka tentuar ta detyrojë Dëshmitarin A (i njohur si "Dëshmitari I" në lëndën GJPP 27/12 (PPS 88/11)) edhe duke i premtuar atij një përfitim, me qëllim që ta nxis Dëshmitarin A në lëndën e gjykatës numër GJPP 27/12 (PPS 88/11) të refuzojë të japë deklaratë në ato procedura.

Prandaj, sipas nenit 364, para. (1) nënpara. (1.3) të KPP, i Pandehuri **M. Z. _____ LIROHET NGA AKUZA**, për kryerjen e veprës penale "Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare në tentativë", në kundërshtim të nenit 28 dhe 394, para. (1) nënpara (1.7) KPK.

IV.

Sipas nenit 454, para. (1) KPP, shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga burimet buxhetore.

Franciska Fiser

Kryetare e Trupit Gjykses, Gjyqtare e EULEX-it

Vladimir Mikula

Anëtar i Trupit Gjykses

Gjyqtar i EULEX-it

Arkadiusz Sedek

Anëtar i Trupit Gjykses

Gjyqtar i EULEX-it

Chiara Tagliani

Procesmbajtëse

Personat e autorizuar kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të një kopje të këtij aktgjykimi (Neni 380, para. (1) KPP).